



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:021305
Datë: 04.04.2024
Numri i dokumentit: 05542081

PA1.nr.1038/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Ferit Osmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Gentijana Manaj-Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.M nga fshati....., Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale Vjedhje grabitqare në vazhdimësi nga neni 316 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.510/21 të dt.22.06.2023, me datë 02.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.510/21 të dt.22.06.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjakovë, me aktgjykimin, P.nr.510/21 të dt.22.06.2023, të akuzuarin E.M e ka liruar nga akuza për shkak të veprës penale Vjedhje grabitqare në vazhdimësi nga neni 316 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, në bazë të nenit 363 paragrafi 1 nën par.1.3 të KPP-së. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Prokuroria Themelore në Gjakovë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës të anulohet aktgjykimin e ankimuar dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në shkallë të parë.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1074/23 të datës 21.08.2023, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, të anulohet aktgjykimin i ankimuar dhe çështja të kthehet në procedurë të mëtejshme në rigjykim dhe rivendosje .

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Prokuroria Themelore në Gjakovë PP/I.nr.1/2018 dhe PP/I.nr.2/2018 i dt. 11.08.2023 e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me pretendimet se gjykata e shkallës së parë nuk e ka përpiluar aktgjykimin në pajtim me nenin 395 të KPRK-së ngase në aktgjykimin e kundërshtuar nuk paraqiten në mënyrë të qartë dhe të plotë faktet ose provat të cilat i konsideron si të vërtetuara ose të pavërtetuara, po ashtu gjykata nuk ka vlerësuar as saktësinë e provave të paraqitura në aktin akuzues e posaçërisht mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale. Pra dispozitivi i aktgjykimit është kundërtënes me arsyetimin e aktgjykimit lidhur me faktet vendimtare, kurse është kontradiktor dhe nuk janë paraqitur arsyet e duhura dhe bindëse mbi faktet vendimtare, kurse ato që janë paraqitur janë hipotetike dhe në kundërshtim me përmbajtjen e procesverbaleve në shkresat e lëndës, nuk kanë mbështetje të duhur në provat e administruara , shkelje këto që janë të ndërlidhura me gjendjen faktike ngase edhe gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë është në kundërshtim të plotë me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Lidhur me vërtetimin e gjendjes së gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike , pretendon se gjykata gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit, kur ka marr aktgjykim lirues për të akuzuarin dhe gabimisht ka aplikuar parimin In Dubio Pro Reo, pasi që në këtë çështje penale nuk ka pasur asnjë mëdyshje sa i përket përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe veprimeve të tij në drejtim të veprës penale Vjedhje grabitqare në vazhdimësi nga neni 316 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së dhe po të konstatohej në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendja faktike, do të rezultonte me një vendim tjetër nga ajo që ka marr gjykata e shkallës së parë, pra gjykata e shkallës së parë bazuar në provat që i janë bashkangjitur shkresave të lëndës do të duhej që të akuzuarin ta shpallte fajtor dhe ta dënonte sipas ligjit. Nga e gjithë kjo që u tha më lartë, pretendon se janë të dhëna të mjaftueshme të cilat në mënyrë të kuart dëshmojnë se vendimi mbi lirimin nga akuza kundër të pandehurit E.M është i pa drejtë dhe si i tillë i pa qëndrueshëm. Gjykata me rastin e marrjes së aktgjykimit ka shkelur ligjin penal në favor të të akuzuarit duke rënë ndesh me dispozitivin e nenit 316 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, ku në këtë çështje penale me veprimet e të

akuzuarit janë përmbushur elementet qenësore të kësaj vepre penale, pasi nëse analizohet dispozita e nenit 316 par.1 të KPRK-së rezulton se vepra penale konsiderohet se është kryer kur personi i zënë në befasi në kryerjen e faktit të vjedhjes dhe me qëllim që pasurinë e vjedhur ta mbajë, e përdor forcën apo kanosjen serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, e duke u ndërlidhur me veprimet e të pandehurit i cili dy herë radhazi ka kryer veprën penale duke përdorur forcën ndaj të dëmtuarve N.R dhe D.M me qëllim të marrjes së pasurisë, Prokurori i Shtetit konsideron se janë plotësuar të gjitha elementet e veprës penale Vjedhje grabitqare në vazhdimësi. I propozon Gjykatës së Apelit të Kosovës të anuloj aktgjykimin e ankimuar dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në shkallë të parë.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke u bazuar në nenin 394, paragrafi 1. të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit edhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kjo gjykatë i vëren çdo herë sipas detyrës zyrtare, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. Aktgjykimi i ankimuar është konkret dhe i qartë, në arsyetimin e aktgjykimin të kundërshtuar gjykata e shkallës së parë ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar. Gjykata e shkallës së parë provat i ka vlerësuar në pajtim me dispozitat e KPPK-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merr si të provuara ose të pa provuara. Në arsyetimin e aktgjykimin përkitazi me ngjarjen e kryerjes së veprës penale në fjalë, janë dhënë arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje juridike penale, të cilat si të drejta i aprovon edhe kjo gjykatë dhe nuk e sheh të nevojshme të bëjë edhe njëherë vlerësimin për këtë.

Sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë nuk janë të bazuara, kjo për faktin se gjendja faktike në këtë çështje penale është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ngase sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari të ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza për veprën penale me të cilën është akuzuar, sepse nga të gjitha provat e administruara dhe vlerësuara, sikurse janë provat personale dhe materiale dhe atë deklaratat e të dëmtuarave D.M dhe N.R, dëshmitarëve E.M, M.G – zyrtarë policor, B.B, si dhe provave materiale, Raporti i oficerit A.A me #9836# dt. 03.08.2017 nr. Rasti 2017-EA-847, Raporti i oficerit A.A #9836# dt. 04.08.2017 me nr. Rasti 2017-EA-847, Dëftesa mbi konfiskimin e pronës nga S.H ,dt. 30.09.2017. me nr. Rasti 2017-EA-847, te një telefonit IPHOHNE 6 me nr. IMEIT -35540007381549, Raporti i hetuesit M.G me nr. Rasti 2017-EA-847 dt. 30.09.2017, shikimi i foto dokumentacionit mbi identitetet e me parmë dhe fotot fq.1 dhe 2; Raporti i oficerit Z.D me #9993 # dt.12.08.2017, me nr. Rasti 2017-EA-887, Nga Raporti i hetuesit dt. 30.09.2017 me nr. të njëjtë të rastit, Raporti i hetuesit M.G dt. 26.10.2017 me nr. Rasti 2017-EA-887, Njoftimi nga sektori i hetimeve i zyrtarit policor E.H i datës 16.11.2022, si përgjigje lidhur me kërkesën për verifikimin në arkivën e St. Policor në rastet 2017-EA-847 dhe 2017-EA-887, se a kanë ndonjë CD me video incizim, dhe Raporti informues nga Njësia e Hetimeve Regjionale –Polica Kufitare perëndimi në Gjakovë dt.14.11.2022, lidhur me hyrje –

daljet në kufi të personit të dyshuar E.A.M, pra të gjitha provave së bashku si dhe secilës prej tyre veç e veç, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza për veprën penale me të cilën është akuzuar. Pra kolegji vlerësoi se gjendja faktike në këtë çështje penale është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ngase me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor si ato personale ashtu edhe ato materiale nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ta ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Marrë parasysh deklaratat e të dëmtuarve dhe provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë në rastin konkret me të drejtë ka aplikuar parimin In Dubio pro reo. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konkludimet e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me faktet vendimtare i konsideron të drejta dhe të ligjshme pasi që nuk është provuar që i akuzuari është kryerës i veprës penale për të cilën akuzohet. Këtë gjendje faktike gjykata e konstatoj duke u bazuar në faktin se ka mungesë të provave për vërtetimin e gjendjes faktike reale, andaj kolegji i gjykatës së apelit andaj i vlerëson si të drejta dhe të ligjshme përfundimet e gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me faktet vendimtare në këtë çështje penale, ngase me provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor nuk ka mundur të provohet përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se i akuzuari ta ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, të cilat janë të theksuara më lart, andaj kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës konstaton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur të akuzuarin e lartcekur e ka liruar nga akuza, pasi që gjendja faktike në këtë çështje penale është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.1038/23, më datë 02.04.2024

Procesmbajtësja,
Gentijana Manaj-Gashi

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Abdullah Ahmeti

Ferit Osmani